



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

**V E N D I M**

**NR 34/2, DATË 14/02/ 2018**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN FOTOVOLTAIK ENERGJITIK 50 MWAC, NOVOSELË, ME SUBJEKT APLIKUES “NOVOSELË PHOTOVOLTAIC POWER PLANT SHPK”, NUIS/NIPT: L61709021P**

Në mbështetje të Nenit 9 dhe pikës 5 të nenit 17 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut I, pika 2/a të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 dhe Kreut II dhe pikave 8 dhe 10 të VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015, Komiteti i Investimeve Strategjike,

**VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e “Projektit Fotovoltaik Energjitik 50 MWAC, Novoselë”, me subjekt aplikues “Novoselë Photovoltaic Power Plant shpk NUIS/NIPT: l61709021P”, në Novoselë, Vlorë, ZK. Nr.1007, në procedurën e veçantë, pasi realizimi i parkut fotovoltaik është në mospërputhje me destinacionin e parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) Vlorë, miratuar në Këshillin Bashkiak dhe KKT me Vendimin Nr.1, datë 16.10.2017. Sipas PPV Vlorë, në këtë zonë parashikohet realizimi i një aeroporti.
2. Subjekti “Novoselë Photovoltaic Power Plant shpk, NUIS/NIPT: l61709021P”, nuk disponon një autorizim paraprak të vlefshëm, për shkak të përfundimit të afatit të vlefshmërisë 6 mujore të Autorizim Paraprak (për vazhdim procedure) nga MEI Nr. 4571/5, datë 11.11.2016 “Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse në zonën Novoselë, Bashkia Vlorë.
3. Subjekti “Novoselë Photovoltaic Power Plant shpk, NUIS/NIPT: l61709021P”, nuk paraqiti asnjë dokumentacion të kërkuar nga ligji në fuqi, brenda afateve të autorizimit paraprak, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për energjinë. Mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afateve të autorizimit

paraprak, automatikisht humbet të drejten e fituar në përfundim të afateve të percaktuara në miratim.

4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet me shkrim kërkuesit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit Teknik të Komitetit të Investimeve Strategjike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, pas zbardhjes nga Sekretariati Teknik.

**KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTËR**

EDI RAMA

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
DAMIAN GJIKNURI

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
ARBEN AHMETAJ

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
NIKO PELESHI

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
BLENDI KLOSI

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**  
ALMA HICKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS